

Zyrës për Doktoraturë te Universitetit të Tetovës  
Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen, e mbajtur më **16.11.2021** solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional e dorëshkrimit të temës së doktoraturës me titull: ***"Paleografija dhe gjuha diplomatike e dokumenteve në gjuhën osmane në Arkivin e Kosovës"*** të kandidates **Mr. Hatixhe Ahmedi**.

Në bazë të vendimit **16-204/4** të datës **16.11.2021**, Komision i përbërë nga: **Prof.dr. Abdulla Hamiti** (kryetar), **Prof.dr. Adnan Ismaili**, **Prof.dr. Qani Nesimi**, **Prof.dr. Fehari Ramadani** (anëtarë) dhe **Prof.dr. Sulejman Baki** (mentor), pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës, i paraqet këtë:

**RAPORT**  
*për vlerësimin e punimit të doktoraturës*

Të dhëna biografike për kandidatin

Mr. Hatixhe Ahmedi, e lindur më 16.08.1975 në Preshevë. Në vitin akademik 1996/1997 regjistroi studimet deridiplomike në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, ku ka diplomuar më 19.06.2002. Në vitin 2015/2016, regjistroi studimet pasdiplomike në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Filologji orientale, drejtimi: Gjuhë dhe letërsi turke. Studimet i përfundoi më 25 tetor 2017, me temë te magjistraturës ***"Valorizimi i dokumenteve në gjuhën osmane në Arkivin e Kosovës"***. Në vitin akademik 2018/2019, vazhdoi studimet e ciklit të tretë në Universitetin e Tetovës, Fakulteti Filozofik, në programin studimor: Shkenca për gjuhën, drejtimi; Filologji orientale. Nga viti 2009 është e punësuar në Arkivin e Kosovës, seksionin e dokumenteve të përiudhes osmane. Ka kryer kurs intensiv për gjuhën dhe shkrimin osman. Është bashkëautore e tri monografive të botuara dhe shumë punimeve shkencore nga fushat që janë të lidhura ngushtë me temën e doktoraturës. Ka marrë pjesë në shumë konferenca, simpoziume shkencore në Kosovë, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Turqi. Përveç gjuhës amtare flet dhe shkruan në gjuhën boshnjake, turke dhe arabe.

### Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidatja gjatë studimeve të doktoraturës

Kandidatja me sukses ka realizuar tre konferencat doktorale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Mr. Hatixhe Ahmedi gjatë studimeve të doktoraturës ka botuar dy monografi dhe dy punime shkencore, që janë të lidhura drejtpërdrejt me temën e doktoraturës.

Sadik Mehmeti, **Hatixhe Ahmedi**, Ramadan Shkodra, *Dijetarë shqiptar në Perandorinë Osmane (1880-1912) sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Islam*, Prishtinë, 2021.

Tahir Sezen, *Ndarja administrative e vilajeteve shqiptare* (përktheu, plotësoi dhe përgatiti për botim: Hatixhe Ahmedi), Prishtinë, 2021.

*Analizë e Vakëfnames origjinale të Beqirzade Hasan efendiut, të birit të Abdulla Spahiut në lagjen Ikjaz Kuka të Prizrenit*, në: Revista "VJETARI", Agjencia Shtetërore e Arkivave Kosovës, Prishtinë, 2018.

*Dukja estetike e një dokumenti të vjetër osman- Me vështrim të veçantë një berati të vitit 1315/1898 që ruhet në Arkivin e Kosovës*, në: Revista, "Arkivat Shqiptare", 1-2, Viti 55/2019, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe ASHAK, Tiranë- Prishtinë, 2019.

### Analizë të punimit të doktoraturës

Punimi i disertacionit "Paleografija dhe gjuha diplomatike e dokumenteve në gjuhën osmane në Arkivin e Kosovës", është ndarë, në: Hyrje, tre kapituj, Përfundimi dhe Literaturën e shfrytëzuar.

Kapitulli i parë, *Gjuha diplomatike e dokumenteve osmane*, është ndarë në pesë nënkapituj: *Fillet dhe zhvillimi i paleografisë në Evropë, Zhvillimi dhe karakteristikat e paleografisë osmane, Historiku dhe zhvillimi i diplomatikës ndër shekuj, Aspekte të veprimtarisë arkivore në Perandorinë Osmane, Studiuesit e paleografisë dhe diplomatikës së dokumenteve osmane*.

Në Mesjetë dhe në kohën e re paleografia nuk konsiderohej si shkencë e posaçme. Në shekullin e XVII, krijohen kushte me të volitshme për zhvillimin e shkencave ndihmëse të historisë, sidomos shkencës së diplomatikës dhe paleografisë. Sipas konstatimeve të Antoljakut, ndër të parët që u morrën me paleografi ishin francezët. Në Francë dhe në Gjermani u zhvilluan polemika të shumta rreth autentitetit të disa dokumenteve të dorëshkruara. Paleografia, në fillimin e saj, si shkencë ndihmëse e historisë u ngrit dhe u zhvillua shumë, sa që më vonë në shekullin e XIX dhe XX, u bë degë më vete.

Përgjatë gjithë hapësirës së Pernadorisë Osmane qenë përhapur “*gjashtë llojet e shkrimeve*” të njohura si “*aklâm-isitte*”. Pas periudhës së Tanzimatit, dokumentet të cilat përmbanin tekste të marrëveshjes mes palëve (*ahidnâme*), në përgjithësi ishte zgjedhur të shkruheshin me llojin e shkrimit “*dîvâni*”. Shkrimin e llojit “*ta’lik*”, zakonisht e përdornin intelektualët dhe elita akademike e kohës.

Fjala diplomatikë buron nga gjuha greke, rrënja e saj është fjala “diploma” e cila nënkupton “*gjë e palosur dyfish, letër e palosur*”. Në gjuhën latine kjo fjalë përkthehet si: “*letër rekomandimi dhe letër lejimi apo autorizimi*”. Në Mesjetë fjalët *diplomë, certifikatë dhe dekoratë* në zyrat zyrtare shtetërore është përdorë e zëvendësuarme fjalët *charta, epistola, littera*, etj.

Në çdo diplomë ekziston teksti historik dhe ai diplomatik. Teksti historik është ai vend dhe ato vende në kontekst, të cilat zakonisht shërbejnë për konstatimin apo për mohimin e të dhënavë hisorike. Teksti diplomatik në të vërtetë është teksti i tërë dokumenti: protokolli, kontesti dhe es-hatokoli. Kritika e tekstit të dokumentit është lidhur ngushtë me kronologjinë, filologjinë, jurisprudencën dhe me shkenca të tjera. Dipolomatika është pika fillestare për vlerësimin e autenticitetit të një dokumenti a dëshmie.

Një nga institucionet kryesore të Shtetit Osman ku ruheshin dokumentet, ishte institucioni i quajtur: “*Maliye Defterleri Hazinesi- Thesari (Depoja) i Defterëve të Pasurisë*”, dhe “*Defterhane Hazinesi- Thesari (Depoja) i Defterëve*”. Në këto “*thesare- depo*” ruheshin shumë regjistra dhe dokumente me rëndësi. Në fillim të shek. XVII lënda arkivore (*mahzen-i evrak*) dokumentet dhe defterët u bartën në Sarajin (Pallatin) e Topkapisë.

Mësimet mbi diplomatikën në Perandorinë Osmane filluan në vitin 1909, me themelimin e organizatës “*Tarih-i Osmani Encümeni*” dhe më vonë me nxjerrjen dhe botimin e revistës “*Tarih-i Osmani Encameni Mecmuası*” (1914). Si autorë të parë të pleografisë dhe diplomatikës osmane përmenden Abdurrahman Sheref, Musa Kazem dhe Ismailhakki Uzunçarshili. Fillet e mësimit të paleografisë dhe diplomatikës dhe vendosjes së saj në programet universitare në Turqi janë bërë me nismën e Mehmet Tajjib Gokbilginit dhe Mubahat S. Kutukoglu.

Kapitulli i dytë, **Dokumentet osmane në Arkivin e Kosovës**, është ndarë në pesë nënkapituj: *Aspekte të veprimtarisë arkivore në Kosovë gjatë përiudhes osmane, Zhvillimi i shërbimit arkivor dhe arkivistika në Kosovë pas vitit 1945, Historiku i dokumenteve osmane në Arkivin e Kosovës, Ndarja dhe grupimi i dokumenteve sipas llojit të shkrimit, Llojet e shkrimeve të dokumenteve në gjuhën osmane në Arkivin e Kosovës*.

Për ekzistimin e arkivave të dokumenteve osmane në Kosovë, përvetësuar tjetërash, të dhëna me rëndësi na jepin “Sâlnâmetë” (Vjetarët) e që kanë të bëjnë me Kosovën dhe me trojet shqiptare të njohura me termin përgjithësues “Arnavutluk”. Duke ju referuar këtyre sâlnâmeve të kohës, mësojmë se në kuadër të organeve të vilajetit të Kosovës, p.sh. ka ekzistuar edhe zyra e arkivit (*evrâk mukayyidi*), që ka pasur edhe arkivistë.

Dokumentet osmane ndryshojnë nga forma njëri me tjetrin sepse secili prej tyre trajton problematika nga më të ndryshmet dukefilluar që nga ato me karakter administrativ, të karakterit politik, shoqëror ekonomik etj. Sot në Arkivin Shtetëror të Kosovës ruhen rreth 3000 dokumente në gjuhën osmane, që përfaqësojnë një fond të rëndësishëm, sepse të shumtën ato janë hartuar nga nëpunës dhe personalitetë të vendit dhe për nevoja e interesa të popullatës së Kosovës.

Kronologjia e dokumenteve osmane në Arkivin e Kosovës fillon me dokumentin/vakëfnamenë e Mehmed Pashë Kaçanikut (1608). Dokumentet që ruhen në Arkivin e Kosovës kapin dy shekuj – XVIII – XX, por shumica e tyre është e shekullit XIX dhe vazhdojnë deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore, madje edhe më vonë.

Në administratën osmane secili dokument posedonte llojin e shkrimit të veçantë me të cilin ai duhej të shkruhej. Me një fjalë, ekzistonte protokoll dhe rregull i veçantë i shkrimit të secilit dokument ashtu sipas fushave të ndryshme të cilave ata edhe iu përkisnin. Kandidatja ka sjellë në ilustrim pesë grupet më të përhapura të shkrimit. Në grupin e parë radhiten dokumentet e dorëshkrimeve shumica e të cilave janë të shkruara me shkrim “nes’h”, në grupin e dytë bën pjesë lloji i shkrimit i cili është më i lehtë, më i përhapuri dhe më i kapshëm përsyrin e lexuesit, ai është lloji i shkrimit “rik’a”. Meqë është lloji më i përhapur dhe me shumicë i shkrimit, atëherë edhe në diplomacinë osmane të vilajeteve shqiptare, ky lloj i shkrimit haset në shumicën e dokumenteve të kohës. Lloji tretë i shkrimit është shkrimi “ta’lik”, lloji i katërt i shkrimeve është lloji “divâni”, shkrim nga i cili janë shkruar llojet e dokumenteve: *fermân, berât, hüküm, bujuruldu* etj, kurse në grupin e pestë hyjnë dokumenteve e shkruara me llojin *siyakat*.

Në kapitullin e tretë, *Transkriptimi, përkthimi dhe analiza e gjuhës diplomatike të dokumenteve osmane në Arkivin e Kosovës*, i cili paraqet thelbin e këtij punimi të doktoraturës, kandidatja është zgjeruar më shumë dhe me sukses ka bërë prezantimin dhe zberthimin e paleografisë dhe gjuhës diplomatike të dokumenteve osmane në Arkivin e Kosovës, të cilat i ka marrë në shqyrtim,. Me këtë rast, ka mundur të sjellë nga një shembull nga të gjitha llojet e dokumenteve osmane që posedon Arkivi i Kosovës.

Përzgjedhja e dokumenteve osmane zyrtare që plotësojnë në përpikëri të gjitha rregullat diplomatike, nuk është e lehtë, prandaj për të gjitha këto kandidatja ka dhënë sqarime shtesë, gjithmonë duke konsultuar në përgjithësi literaturën për paleografinë dhe diplomatiken e dokumenteve osmane. Brënda këtij punimi të doktoraturës kandidatja ka prezantuar gjithsej tetëmbëdhjetë lloje të dokumenteve në gjuhën osmane që ruhen në Arkivin e Kosovës.

Dokumentet osmane kanë një tipologji të tillë, sa që me një të shikuar arrijmë të zbulojmë gjuhën e tyre diplomatike, e cila na mundeson ta gjejmë monogramin ose logon e këtyre dokumenteve, e cila vendosej në dokumentet të cilat nxirreshin nga Zyra e Sulltanit (*Defter-i Hakani*), për të vijuar në titujt, ku secila hierarki kishte titullin e vet, pastaj brendia e tekstit të dokumentit, dhe, përfundimi i tij, në të cilin qartë citohej edhe lloji i dokumentit. Rëndësi të madhe në zbulimin e gjuhës diplomatike të dokumenteve ka vendosja e datave, nënshkrimet dhe vulosja e tyre ose myhyrët e kancelarive prej nga edhe lëshoheshin këto dokumente.

Celësi fillestari, ai që na mundeson të dimë nga larg llojin e dokumentit, padyshim se është lloji i shkrimit me të cilin edhe është shkruar ai dokument. Mësimi i gjuhës diplomatike të dokumenteve arrihet të bëhet vetëm pas mësimit të paleografisë së këtyre dokumenteve, sepse paleografia është çelësi i tyre. Asnjë dokument nuk arrihet të interpretohet në formë të plotë nëse nuk e dimë gjuhën diplomatike të tij. Gjuha diplomatike e dokumenteve osmane përbledh njohuritë shumta.

#### Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura

Gjatë hartimit të punimit të doktoraturës me titull “*Paleografia dhe gjuha diplomatike e dokumenteve në gjuhën osmane në Arkivin e Kosovës*”, kandidatja është mbështetur dhe ka respektuar teorinë shkencore dhe metodologjinë e punës kërkimore-shkencore.

Janë shfrytëzuar disa metoda shkencore, si analiza, krahasimi dhe kriticizmi. Për shkak të natyrës së punimit, ndarja është bërë sipas tematikës, çdo nëntemë është e lidhur me njëratjetren.

Kandidatja për përgatitjen e punimit ka shfrytëzuar kryesisht burime arkivore të pabotuara, dokumente të botuara, monografi, zëra enciklopedikë, punime shkencore nga revista të ndryshme, literaturë të përgjithshme kryesisht në gjuhën turke dhe në gjuhën shqipe.

Njohja e gjuhës dhe alfabetit osmane si dhe njohja e gjuhës arabe dhe turke nga ana e kandidatës ka mundësuar që transkriptimi dhe përkthimi të bëhet drejtpërdrejtë nga origjinali.

## Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit

Tema e doktoraturës “*Paleografia dhe gjuha diplomatike e dokumenteve në gjuhën osmane në Arkivin e Kosovës*”, është një përpjekje serioze për një punim monografik përbledhës për të pasqyruar fondin e dokumenteve në gjuhën osmane në Arkivin e Kosovës me theks të veçantë paleografinë dhe gjuhën diplomatike të tyre.

Si përfundim, kandidatja Mr. Hatixhe Ahmedi vlerëson se përgjatë gjithë hapësirës së Pernadorisë Osmane kanë qenë të përhapura “*gjashtë llojet e shkrimeve*” të njoitura si “*aklâm-isitte*”. Këto lloje shkrimesh, shkruheshin sipas llojit që i përshtatej natyrës së atij dokumenti. Në çdo diplomë ekziston teksti historik dhe ai diplomatik. Për ekzistimin e arkivave të dokumenteve osmane në Kosovë, përveç të tjerash, të dhëna me rëndësi na jepin “*Sâlnâmetë*” (Vjetarët), prej ku mësojmë se ka ekzistuar edhe zyra e arkivit (*evrâk mukayyidi*).

Dokumentet osmane ndryshojnë nga forma njëri me tjetrin sepse secili prej tyre trajton problematika nga më të ndryshmet duke filluar që nga ato me karakter administrativ, të karakterit politik, shoqëror ekonomik etj. Në Arkivin Shtetëror të Kosovës ruhen rreth 2.000 dokumente në gjuhën osmane, që përfaqësojnë një fond të rëndësishëm, shumica prej tyre janë hartuar nga nëpunës dhe personalitetë të vendit dhe për nevoja e interesa të popullatës së Kosovës.

Kronologjia e dokumenteve osmane në Arkivin e Kosovës fillon me dokumentin/vakëfnamenë e Mehmed Pashë Kaçanikut e vitit 1608. Në administratën osmane secili dokument posedonte llojin e shkrimit të veçantë me të cilin ai duhej të shkruhej. Shumica e dokumenteve osmane në Arkivin e Kosovës janë të shkruara me shkrim “*nes'h*”, “*rik'a*”, “*ta'lik*”, “*divâni*” dhe “*sijakat*”.

Kandidatja ka mundur të sjellë nga një shembull nga të gjitha llojet e dokumenteve osmane që posedon Arkivi i Kosovës. Brënda punimit të doktoraturës kanddatja ka prezantuar tetëmbëdhjetë lloje të dokumenteve osmane. Dokumentet osmane kanë një tipologji të tillë, sa që me një të shikuar arrijmë të zbulojmë gjuhën e tyre diplomatike.

Rëndësi të madhe në zbulimin e gjuhës diplomatike të dokumenteve gjithashtu kanë edhe vendosja e datave, nënshkrimet dhe vulosja e tyre ose myhyrët e kancelarive prej nga edhe lëshoheshin këto dokumente. Çelësi fillestar, ai që na mundeson të njohim llojin e dokumentit, padyshim se është lloji i shkrimit me të cilin edhe është shkruar ai dokument. Asnjë dokument osman nuk mund të interpretohet në formë të plotë nëse nuk e dimë gjuhën diplomatike të tij e cila përbledh njojuritë shumta dhe kërkon kulturë të gjerë dhe njojje të thellë.

### Kontributet kryesore shkencore të kandidatit

Disa nga tematikat e kësaj teme mund të janë trajtuar nga studiues në punime shkencore të ndryshme, por rendësia e këtij disertacioni është trasnkriptimi, përkthimi dhe analiza e paleografisë dhe gjuhës diplomatike të te gjitha llojeve të dokumenteve në gjuhën osmane që ruhen në Arkivin e Kosovës.

Përmes shfrytëzimit të dokumentacionit origjinal të pabotuar, dokumenteve osmane të botuara dhe të njohura pjesërisht, shfrytëzimit të sllnameve (vjetarëve) dhe literaturës relevante dhe të pasur në gjuhën turke, punimeve dhe monografive në gjuhën shqipe për historikun dhe zhvillimin e arkivistikës në Kosovë dhe zërave enciklopedikë (Enciklopedia islame), kandidatja ka sjellë prurje të reja shkencore, të cilat janë një kontribut sa modest, po aq i çmuar në fushën e historisë dhe filologjisë dhe me theks të veçantë për arkivistikën dhe studimet orientale në hapësiren shqiptare.

Rendësi të veçantë nga të gjitha çështjet të cilat i ka shqyrtau kandidatja në dokumentet e përzgjedhura i ka kushtuar prezencës së shqiptarëve, qoftë si hartues (shkrues) apo subjekt brënda dokumentit, me qëllim që jo vetëm të dëshmohet prezenca por edhe roli dhe pozicioni i shqiptarëve në jetën politike, arsimore, fetare dhe kulturore në Kosovë gjatë përiudhes osmane.

Si përfundim, vlerësojmë se kjo temë e disertacionit paraqet një kontribut të rendësishëm në pasqyrimin e pasurisë arkivore të përiudhes osmane në Arkivin e Kosovës në përgjithësi dhe paraqet studimin e paleografisë dhe gjuhës diplomatike të dokumenteve osmane në veçanti.

### Hulumtime të mundshme të ardhshme

Tema e doktoraturës “*Paleografia dhe gjuha diplomatike e dokumenteve në gjuhën osmane në Arkivin e Kosovës*”, është temë e përgjithshme dhe brënda saj janë trajtuar tematika të ndryshme, kjo krijon mundësi për të qënë një bazë e mirë për hulumtime të ardhshme.


Kandidatja është munduar që për të gjitha llojet e dokumenteve të jap sqarime plotësuese të cilat mund shërbejnë për njohuri të reja jo vetëm në fushën e arkivistikës por edhe të historiografisë shqiptare.

Vlerësojmë se punimet e këtilla janë me interes për zbardhjen e historisë dhe kulturës shqiptare gjatë përiudhes osmane në hapësiren shqiptare janë të pakta dhe si rrjedhojë pak të njohura dhe mund të shërbejnë për zgjerimin dhe thellimin e studimeve të ardhshme.

### **Vlerësim dhe rekomandim**

Nisur nga vlerësimet e sipërthëna Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoraturës me titull “**Paleografia dhe gjuha diplomatike e dokumenteve në gjuhën osmane në Arkivin e Kosovës**” të kandidates **Mr. Hatixhe Ahmedi**, në përbërje të mëposhtme, ka nderin që ti propozoj Këshillit Mësimor –Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe të krijoj kushtet e nevojshme përmbrojtjen publike të këtij disertacioni të doktoraturës.

#### **Komisioni recenzues:**

1. Prof. Dr. Abdulla Hamiti (Kryetar) 
2. Prof. Dr. Adnan Ismaili (anëtar) 
3. Prof. Dr. Qani Nesimi (anëtar) 
4. Prof. Dr. Fehari Ramadani (anëtar) 
5. Prof. Dr. Sulejman Baki (Mentor) 

Tetovë, 28.01.2022.